

PROCESVERBAL
nga seanca e 4-të Publike e Këshillit të
Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale,
mbajtur më 01.08.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, Lazar Trajçev, Zoran Fidanovski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Nëpërmjet videokonferencës i pranishëm në mbledhje ishte edhe Dr. Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes video lidhjes: Mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Mr. Arben Saiti, Maja Damevska, Mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, Dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 4-të publike të Këshillit të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Seanca filloi në ora 12:30 dhe u mbajtë përmes video konferencës.

Z. Petrushevski bëri të ditur se për shkak të pengesave teknike Z. Fidanovski në seancë do të kyçet vetëm nëpërmjet audio lidhjes, pa transmetim me video. Në lidhje me propozimin e rendit të ditës sqaroi se pika 2 do të hiqet përshkak se SHTR Radio Balkan nga Gostivari e pagoi kompensimin vjetor për lejen, respektivisht punën e vet e përshtati sipas Ligjit.

Këshilli i Agjencisë unanimisht me 6 vota për (votimi i Z. Fidanovski ishte nëpërmjet lidhjes audio) e miratoi me korigjim si në vijim:

RENDI I DITËS

1. Arsyetim I Shoqërisë tregtare radiodifuzive televizioni IRIS SHPK Shtip, për veprimin e medias në lidhje me iniciimin e procedurës për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

Z. Petrushevski konstatoi se përfaqësuesi i TV Iris nuk u kyç në seancë. Sepse kjo seancë është dedikuar për arsyetim nga media në lidhje me iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, ndërsa përfaqësues nga mediumi nuk kishte prezent, e mbylli seancën.

Nr. 02-2965/2

15-08.2023
Shkup

**Agjencia për shërbime
mediatike audio dhe audiovizuele
Kryetar,**

Lazo PETRSHUVESKI, d.v